



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Drejtoria për Prokurim Publik
14 Nr.568/23
Dt. 10.07.2023

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të "EL-BAU" SH.P.K., me seli në Gjilan, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik për Dhënie të Kontratës të publikuar më dt.27.06.2023, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Operatori Ekonomik në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, më datën 10.07.2023 mori këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet pjesërisht e bazuar Kërkesa për rishqyrtim, e subjektit në procedurë: "EL-BAU" SH.P.K., me seli në Gjilan, në procedurën e prokurimit me titull: "Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Vushtrri, Prokurimi: VU644-23-3378-5-2 -1, Nr. i brendshëm: VU644-23-0024-521.**
 1. Autoritetit Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së dhe nenin 62 paragrafi 62.1 pika (d) të Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues do të vazhdoj me ri-vlerësim të aktivitetit të prokurimit.
 2. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Me vendimin e Autoritetit Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik, në aktivitetin e prokurimit: "EL-BAU" SH.P.K., me seli në Gjilan, në procedurën e prokurimit me titull: "Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Vushtrri, Prokurimi: VU644-23-3378-5-2 -1, Nr. i brendshëm: VU644-23-0024-521, të shpërblej me kontratë Operatorin Ekonomik: "Haxha Kom" Sh.p.k.


Në Kërkesën për rishqyrtim parashtruar nga OE. "EL-BAU" SH.P.K., me seli në Gjilan, e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, parashtruesi i Kërkesës konsideron se me këtë rast: gjate procesit te vlerësimit te tendeve te O.E. "Haxha Kom" Sh.p.k. dhe "Rahovica Commerce" janë shkelur dispozitat e LPP-së dhe RRPP-së, nenet 59, 60, 61 lidhur me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP-së dhe legjislacionin sekondar nga nenin 40, nenin 41 lidhur me nenin 4.3 të RRPP-së Nr.001/2022.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të Ankuesit të paraqitura përmes Kërkesës për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, u konstatua se kërkesa për rishqyrtim e ankuesit është pjesërisht e bazuar, pasi që OE "EL-BAU" SH.P.K konsideron se AK VUSHTERRI nuk i ka trajtuar drejtë/barabrtë dhe në bazë të kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit OE tjera pjesëmarrëse për këtë aktivitet të prokurimit.

AK ka shpallur fituesin, duke menduar se O.E i rekomanduar për dhënie të kontratës ka përmbushur kërkesat e saktësuara në FTD, andaj, pas ri-shqyrtimit të kërkesave të saktësuara, pretendimeve ankimore të parashtruesit të Kërkesës për Rishqyrtim dhe verifikimit të të gjeturave tjera rreth rivlerësimit të tenderit të Ankuesit, do të konkretizohen dhe materializohen gjatë procesit të ri-vlerësimit në Raportin e ri-vlerësimit.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 pika (d) të Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues, është vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Drejtoria për Prokurim Publik



Alban Tahiraj, drejtor

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Nga një kopje i dërgohet:

1x1 Palës/ ve;
1x1 DPP, dhe
1x1 Arkivit.